



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +383-28535725/535727

Prof. Dr. Ali Topalli, kryesues i KD

Nr. 1990 dt. 04.12.2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, duke vendosur mbi propozimin e menaxhmentit, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, neni 35, paragrafi 7, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2020, morri:

**VENDIM**

1. Personeli akademik në vitet jubilarë të punësimit të tyre do të kompensohen në harmoni me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, sipas lartësisë të paraparë me nenin 35, paragrafi 7.
2. Kompensimi do të bëhet për të gjithë ata të cilët në vitet kalendarike 2017; 2018; 2019 dhe 2020 janë në vitet jubilarë të punësimit të tyre, respektivisht prej hyrjes në fuqi të kontratës në vitin 2017.
3. Kompensimi do të bëhet për jubileun e fundit.
4. Kompensimi si më lartë do të bëhet nga buxheti paga dhe mëditje dhe do të ekzekutohet me pagën e dhjetorit 2020.
5. Obligohet zyra për buxhet dhe financa për realizimin e këtij vendimi.

**ARSYETIM**

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, duke shqyrtuar propozimin e menaxhmentit për kompensimin e personelit akademik për vitet jubilarë ka konstatuar se me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, institucionet arsimore, në këtë rast edhe IAL dhe Universiteti i Mitrovicës kanë obligim që personelin akademik ti kompensojnë në vitet jubilarë të tyre në harmoni me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Marr parasysh që kontrata është në fuqi nga viti 2017, dhe në pamundësi për të ekzekutuar këtë obligim në vitet jubilarë 2017; 2018 dhe 2019, KD ka vendosur që këtë obligim ta kryej edhe për vitet paraprake prej hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Arkivit të UMIB;
- Zyrës për buxhet dhe financa;
- Zyrës së personelit;
- Zyrës ligjore

Prof. Dr. Ali Topalli

Kryesues i KD

